



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 18 DHJETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 18.
DECEMBRA 2008. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetari i Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Hapim punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë, çka do të thotë se mund t'ia fillojmë punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia paraqet rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Zotërinj ministra,

Meqë tash është radha të diskutohet për rend të ditës, unë po e bart disponimin e grupit parlamentar dhe marrëveshjen me disa shefa të grupeve parlamentare, jo me të gjithë, që pika e katërt e rendit të ditës të tërhiqet- Ligji për Presidentin, në leximin e dytë. Arsyetimi është nga grupi ynë parlamentar se ky ligj duhet të vijë bashkë me Ligjin për deputetët dhe me Ligjin për Kryeministrin. Ne kërkojmë që të tërhiqet nga rendi i ditës.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, është radha e grupeve parlamentare. Në emër të LDK-së, kush e dëshiron fjalën? E ka fjalën deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Unë nuk di me cilët kryetarë grupesh ka biseduar kolegu. Unë nuk shoh kurrfarë arsyeje që një ligj, i cili i ka kaluar rregullat procedurale të Parlamentit, të kushtëzohet me ligje të tjera, për shkak se në procedurë është në mënyrë të rregullt dhe s'e di se si do të kushtëzohet me ligjet që s'ekzistojnë ende në procedurë parlamentare, një ligj që është në Parlament. Pra, nuk ka arsye logjike të kushtëzohet një ligj që është në procedura të rregullta parlamentare, me ligjet që mund të vijnë. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Sipas radhës, le të prononcohen shefat e grupeve parlamentare.
E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra, deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së, për shkak se, po ashtu, në procedim të rregullt ka qenë edhe Projektligji për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, është i mendimit që kjo pikë e rendit të ditës duhet të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të vijë në një fazë kur do të jenë edhe ligjet të cilat u përmendën më herët, prandaj si grup parlamentar e përkrahim këtë kërkesë.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit, shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht, po them që edhe ne pajtohemi që të mos procedohet më tutje ky ligj, mirëpo mendojmë se ky kthim duhet të konsiderohet si refuzim i Kuvendit për ta votuar ligjin, për shkak se arsyeja pse po e heqim prej rendit të ditës, është se e kemi të qartë se ligji nuk do të votohet.

Tani po e gjejmë një rrugë që ky ligj të mos vijë në pozicion që të hidhet poshtë nga Kuvendi i Kosovës dhe të hiqet, mirëpo të mos na vijë edhe një herë i njëjtë. Ne, po ashtu, mendojmë se ligji nuk korrespondon me frymën të cilën ne po e ndërtojmë në Kosovë. Është një ligj i keq dhe do të ishte gabim serioz nëse tërhiqet sot dhe në një të ardhme të afërt të na vijë i njëjtë prapë në Kuvend. Do të thotë, lë të konsiderohet kjo si një refuzim i Kuvendit për ta votuar këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli, e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDD-së edhe gjatë shqyrtimit të parë ka adresuar një varg vërejtjesh sa i përket këtij projektligji, mirëpo kur bëhet fjalë tash a të jetë në rendin e ditës apo të tërhiqet, ne plotësisht pajtohemi që të tërhiqet, për vetë faktin se materia e këtij projektligji qysh është pretenduar të adresohet, ka ndryshuar dhe tash jemi në një situatë kur ky projektligj edhe sikur sot të votohej këtu, Grupi Parlamentar i LDD-së do të votonte kundër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz.

SADIK IZDRIZ: Predsedniče, mi smatramo da bi bilo poželjno da ako se složi većina ovih grupa, da se ovaj Zakon odloži, s tim da bi zaista bilo potrebno da i Zakon o pravima poslanika jednom već dođe na dnevni red.

Želim da iskoristim priliku da se ne javljam ponovo, jednu opasku. Nekoliko puta ovde za govornicom parlamenta insistiram od vlade da preduzme korake o zastavljanju manipulacija u Ministarstvu za povratak sa projektima. Imamo, znači, podatke da su dobili projekte i nevladine organizacije koje nisu još registrovane i tako dalje. Zbog tih razloga je i poslanik Grbić napustio tu grupu i zaista mislim da vlada, pre nego što se zatvori fiskalna godina, treba da zauzme stav. Ukoliko nismo u pravu, mi ćemo se izvinuti ovde javno pred Parlamentom da smo govorili pogrešno i da smo napadali bez razloga nekoga. Ali, smatramo da to mora da se zaustavi jer je obaveštena Antikorupciska agencija, ali mislim da i vlada treba da preduzme sve mere. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së, nuk ka të lajmëruar.

Pra, një herë e kemi këtë pikë të rendit të ditës. Dëgjuat prononcimin e shefave të grupeve. Kalojmë në votim për mocionin. Mocioni është që ligji të shtyhet, të vijë së bashku me ligjet e tjera, me Ligjin për deputetët dhe të Qeverisë. Ky është mocioni i kërkuar nga shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Kush është për mocionin e shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, lë ta ngritë dorën? Faleminderit! Kush është “kundër”? Kush abstenon? Pra, me sa duket, nuk ka as “kundër” as abstenim.

Në sallë janë prezentë 70 deputetë. Për mocionin 50 kanë votuar “për”, 11 “kundër” dhe 1 abstenim.

Konstatoj se Projektligji hiqet nga rendi i ditës, për t’u kthyer më vonë. Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Esat Brajshori. Esat, ju njoftoj se i keni 2 minuta në dispozicion.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, më 21 prill 2008, ia ka bërë një rekomandim Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që ta shqyrtojë listën e propozuar nga Komisioni i Pavarur të Mediave, të datës 8.6.2007, për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Komisioni për Shërbime Publike ka konstatuar se Komisioni i krijuar ad-hoc atë kohë nuk është konstituuar në mungesë të kuorumit dhe lista e propozuar nga KPM-ja, e datës 8.6.2007, për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, ka mbetur e pashqyrtuar

Në bazë të këtij rekomandimi, Kryesia e Kuvendit ka ardhur në përfundim dhe i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Mediave, që në një afat sa më të shpejtë të riprocedohet me shpalljen publike për zgjedhjen e kandidatëve të anëtarëve të Bordit të RTK-së, meqë lista e propozuar më parë i është adresuar Kuvendit nga mandati i kaluar. Pra, bëhet fjalë për legjislacionin e kaluar.

Ky përfundim që ka sjellë Kryesia e Kuvendit është i datës 12 maj 2008. Ndërkohë, Komisioni i Pavarur i Mediave ka hapur konkursin, pastaj edhe një konkurs tjetër plotësues, mirëpo emrat nuk i ka dorëzuar në Komisionin për Media.

Duke u nisur nga kjo, Komisioni Parlamentar për Media i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Mediave, më 6.10.2008, që në bazë të dispozitave ligjore, në afatin sa më të shkurtër, ta dërgojë listën e propozuar për anëtarët e Bordit të RTK-së.

Në bazë të kësaj kërkesë të Komisionit për Media ...

KRYETARI: Faleminderit, Esat!

Është mirë që Komisioni për Media t’ia bëjë një kërkesë me shkrim edhe Kryesisë për ta futur në rend dite këtë çështje.

Ju njoftoj se për rend të ditës i keni 2 minuta në dispozicion.
Fjalën e ka kërkuar deputetja Donika Kadaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit, Kryetar për fjalën!

Unë para se të paraqes kërkesën, do ta lexoj para jush dhe këtij Kuvendi nenin 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

Neni 2- Sovraniteti.

“Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet në pajtim me Kushtetutën nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute”

Nën dy, “Sovraniteti dhe integriteti i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj”.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ditët që lamë pas, për Republikën e Kosovës kanë paraqitur një shkelje të rëndë të sovranitetit dhe të integritetit të saj nga shteti fqinj Serbia, e cila me qëllim të propagandës dhe të nxitjes së dhunës, bëri shkelje të rëndë të ligjeve në fuqi, respektivisht të Kushtetutës së Kosovës.

Prandaj, duke u thirrur në pikën 29 të Rregullores së Kuvendit, si çështje urgjente paraqes para jush kërkesë për debat të menjëhershëm sot, me theks të veçantë në pikat- kërkesë për Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të ndërmarrë masa të menjëhershme që lëvizjet ilegale në vendin tonë të ndërpriten. Të shtrihet autoriteti kushtetues në mbarë Republikën e Kosovës, pa pritur vonesat e tjera të cilat na dërgojnë drejt ndarjes së vendit, të respektohen ligjet në fuqi nga ky Kuvend që garantojnë sigurimin e kufijve dhe kontroll ndaj të gjitha hyrjeve dhe daljeve në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Vonesa dhe lojërat politike që po bëhen në formimin e FSK-së, Inteligjencës dhe Këshillit të Sigurisë, na kanë sjellë në këtë moment që Kosova sot të rrezikohet nga ndarja. Prandaj, kërkoj nga deputetët që kanë përgjegjësi para qytetarëve të Kosovës sot të votojnë “pro” debatit dhe të dalim me një deklaratë të fuqishme, ku do të kërkojmë nga institucionet relevante që praktikat....

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj të shpreh shqetësimin e thellë për mospërbushjen e përgjegjësive që kanë Kryeministri i Kosovës dhe Presidenti në emërimin e komandantit të FSK-së. Derisa NATO-ja po e përmbush përgjegjësinë e saj, Qeveria dhe Presidenti nuk po e përmbushin këtë. Dëshiroj të theksoj edhe njëherë se sa muaj më parë Kryeministri i Kosovës pati thënë se urgjentisht do ta bëjë zgjedhjen e drejtorit të Agjencionit të Shërbimit.

Prandaj, kërkoj nga Kuvendi i Kosovës, që urgjentisht ta udhëzojë Qeverinë që t'i përmbushë përgjegjësitë kushtetuese që ka. Siç dihet, FSK-ja është një organizatë shumë e rëndësishme për funksionimin e shtetit të Kosovës, është shtyllë e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë, më datën 16, duke hyrë në ndërtesën e Qeverisë të Kosovës, kam takuar rreth 100 punëtorë të ish- "Ramiz Sadikut", të cilët kërkojnë 20% nga shitjet e aseteve të tyre. Në përgjithësi, "Ramiz Sadiku" është shitur 23 milionë e 700 mijë euro, deri më tani, ndërsa 20% e tyre nuk u janë ndarë, edhe pse shitja e fundit është bërë para 3 vjetësh. Do të thotë, atyre u kanë takuar 5 milionë euro dhe nëse e bëjmë 10% kamatë mujore nga bankat që kanë fitim, këtu del se 1 milion e 500 mijë euro dikush i ka gëlltitur.

Fjala është se punëtorët e "Ramiz Sadikut" kanë pasur një takim me zëvendësministrin e Financave para një muaji dhe a e dini se çka u ka thënë? Ai u ka thënë: "Në këtë ndërtesë, po ta dini ju kush punon, kishit për t'u çmendur". Dhe, më vonë u ka thënë: "Në këtë ndërtesë punojnë dy palë njerëz, një palë njerëz që nuk dinë për vendet e punës që i mbajnë, dhe një palë njerëz që punojnë për interesa të veta personale". Këto fjalë ia ka thënë zëvendësministri i Financave përfaqësuesit të Sindikatave të "Ramiz Sadikut", Remzi Dragushës. Unë me këmbëngulësi kërkoj nga Kuvendi i Kosovës, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që sa më shpejt që është e mundur t'ua paguajë 20% punëtorëve, sepse është pronë e tyre. Ata e kanë dhënë djersën, këtë ndërtesë e kanë ndërtuar ata punëtorë dhe ndërtesat për rreth që i kemi i kanë ndërtuar punëtorët e "Ramiz Sadikut" dhe ata kanë të drejtë. Unë kam biseduar menjëherë me ministrin e Financave dhe ministri i Financave më ka thënë që kanë të drejtë dhe më ka udhëzuar të bisedojnë me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës, mirëpo ne Agjencinë e Privatizimit e kemi votuar këtu dhe ne s' kemi çka të bisedojmë me Agjencinë, Qeveria bisedon me ata.

KRYETARI: Faleminderit, Gani!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zoti Kryetar, nuk është hera e parë që sovraniteti dhe integriteti i shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës shkelet nga shteti serb, sidomos me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, andaj unë mendoj që kjo është çështje urgjente, duhet të debatohet sot në Parlamentin e Kosovës. Pra, si grup Parlamentar, si opozitë kërkojmë që të jetë debati domosdo në seancën e sotshme.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Çështjet që i keni ngritur nuk janë urgjente, mund t'i bëni kërkesat me shkrim dhe me procedura të rregullta mund të hyjnë dhe mund të debatohen në Kuvendin e Kosovës. Të lajmëruar tjerë nuk kemi, vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është:

- Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 4 dhjetor 2008

Ju njoftoj se Procesverbali dhe Transkripti i seancës plenare, të mbajtur më 4 dhjetor, u janë shpërndarë deputetëve. Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbal? Pasi nuk kanë vërejtje, konsideroj se Kuvendi miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 4 dhjetor 2008.

Pika e dytë e rendit të ditës është:

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se ministri i Shëndetësisë ka kërkuar që t'i bëjmë pyetjet së pari për shkak se ka një obligim tjetër. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

Deputet Smaka, mund ta bëni pyetjen!

RIZA SMAKA: Faliminderit, zoti Kryetar!

Pyetje kuvendore referuar Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe Fakultetit të Mjekësisë. Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Fakultetin e Mjekësisë, në të apo mbi të, sot aktualisht reflektojnë shumë probleme në natyrën organizative- strukturore dhe funksionale, ndër të tjera, për shkak të definimit konfuz të relacioneve reciproke ndërmjet tyre. Edhe më parë, si dhe edhe sot e kësaj dite, konstatohet dhe konkludohet se ekziston nevoja imediate për një rikonfigurim kualitativ të atyre dy subjekteve juridike të nomenklaturës së shëndetësisë dhe të arsimit shëndetësor superior, por konkretisht së paku me ndonjë rezultat të pritur, deri tani nuk është bërë ndonjë hap në atë drejtim.

Zoti ministër, me konsiderata ju pyes për opinionin, përkatësisht vizionin programor të cilin do ta implementoni këtë çështje topike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, mund të përgjigjesh.

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju falënderoj, zoti Kryetar, për mundësinë që të përgjigjem me prioritet, sepse sot në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për herë të parë bëhet implantimi i deferblatorit intrakardial, implantim i cili bëhet vetëm në qendrat më të avancuara të mjekësisë.

Zoti deputet, Smaka, organizimi në Qendrën Klinike të Fakultetit të Mjekësisë dhe në Fakultetin e Mjekësisë në këto vitet e fundit nuk është ai organizim të cilin ju e keni lënë si sekretar i përgjithshëm i Fakultetit të Mjekësisë në vitet '80-ta. Qendra Klinike Universitare aktualisht, si pjesë e Fakultetit të Mjekësisë, është një organizim i posaçëm i cili nuk haset në vendet tjera. E kemi Emergjencën aty, nën dy, është spital i qytetit për Prishtinë edhe për shumë qytete përreth dhe njëherësh është Qendër Klinike terciare.

Më lejoni t'ju ofroj renditjen e masave të cilat jemi duke i marrë lidhur me pyetjen që ju e shprehni.

Është vlerësim i yni dhe atë e kemi thënë edhe në Kuvend, edhe në Qeveri, edhe në medime se në këtë Qendër kjo gjendje organizative është e paqëndrueshme dhe këtë e mbështesin edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Banka Botërore, e cila ka dhënë draftin e parë të rekomandimit për riorganizimin e Qendrës Klinike Universitare. Ne jemi të përkushtuar që në përpikëri ta zbatojmë master planin e ofruar nga Banka Botërore.

Nën dy, me kryetarin e qytetit të Prishtinës jemi duke bërë përpjekje maksimale që t'i sigurojmë mjetet për themelimin e Spitalit, që kjo pjesë e shërbimeve dytësore të shkarkohet nga Qendra Klinike Universitare.

Nën tre, me agjendën legjislative të vitit 2009 është paraparë rishikimi i Ligjit për shëndetësi dhe në një debat në Qeveri e në Kuvend dhe në Qendrën Klinike Universitare ky anagram do të ndryshojë.

Në bashkëbisedim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ne do t'i shqyrtojmë raportet të cilat aktualisht ekzistojnë në mes të pjesës klinike dhe kësaj edukative dhe me marrjen e kompetencave shtesë buxhetore të universiteteve dhe të Fakultetit të Mjekësisë, jam i bindur që dinjiteti i profesionit do të ngrihet. Duke e mirëpritur pyetjen, unë ua kam përcjellë me postë elektronike edhe një përgjigje më të gjatë lidhur me interesin tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputet, a keni pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Ju faleminderit!

Kam pritur përgjigje konkrete, se dihet, Panta rei, e Heraklitit: "Çdo gjë lëviz, nuk është sot ajo çka ishte dje", po atë po e lëmë anash.

Çështja e QKUK- së është çështje shumë problemore edhe do të duhej medoemos të rregullohej me një ligj. Pra, në këtë drejtim, pyetja ishte, e në këtë drejtim do të duhej edhe politikat e Ministrisë së Shëndetësisë të koncentrohen që ai institucion, tepër i rëndësishëm, të rregullohet ashtu si duhet. Aty ka shumë probleme për të cilat do të mund të flisnim me orë të tëra. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Pyetja e radhës është pyetja e deputetit Armend Zemaj, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputet, e keni fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Sipas të dhënave, në vendin tonë çdo ditë kemi rritje të numrit të pacientëve me probleme mendore, si probleme të depresionit dhe të skizofrenisë dhe sëmundje të ndryshme psikike, ndërsa mënyra e kurimit, zoti ministër, ende është një mënyrë klasike, që nuk ka asnjë ndryshim nga e kaluara, të cilat i trajton të sëmurit mendor në mënyrë të izoluar dhe të ndarë nga komuniteti.

Zoti ministër, ju dhe Ministria e Shëndetësisë, a keni statistika për këtë kategori të të sëmurëve dhe cila është strategjia juaj për kurimin dhe trajtimin e tyre, si dhe integrimin në shoqëri në vendin tonë?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, deputeti Zemaj për pyetje që është një prej preokupimeve jo vetëm të Ministrisë së Shëndetësisë, por të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, po ashtu, si dhe të shoqërisë në përgjithësi, që është një prej problemeve të mëdha të pasojave të konfliktit afatgjatë në Kosovë.

Reforma e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë, në bazë të planit strategjik, ka shënuar rezultate inkurajuese. Ministria e Shëndetësisë e ka hartuar strategjinë e shëndetit mendor të Kosovës për vitin 2008-2013, dhe Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor është në 7 struktura administrative të ndërlidhura në mënyrë funksionale, ku ofrohen shërbimet e shëndetit mendor të mbështetur në forcat përballuese të individit, të familjes dhe të bashkësisë së gjerë.

Mirëpo, nevojat e mëdha në rrafshin e shëndetit mendor, kufizimet serioze buxhetore, vështirësitë në organizimin e shërbimeve spitalore dhe jashtë spitalore të shëndetit mendor, si dhe riorganizimi i Entit Special në Shtime, si pjesë e shërbimit funksional, paraqesin njërën prej vështirësive.

Shërbimi i Shëndetit Mendor në Kosovë, në komunitet, në periudhën e pasluftës ka arritur të reformohet dhe të zhvillohet në struktura të reja të shëndetit mendor, bazuar në bashkësi. Aktualisht, në Kosovë janë në funksion 8 qendra të shëndetit mendor, të bazuara në bashkësi, dhe ato janë në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë dhe Podujevë dhe 8 shtëpi integruese me nga 10 shtretër, me përkujdesje 24 orë, në të cilat janë duke funksionuar për trajtim të rehabilitimit dhe integritetit të sëmurëve kronikë psikiatrikë, siç e përmendët ju skizofreninë, depresionin dhe këto kategori tjera të sëmundjeve.

Shtëpitë integruese me nga 10 shtretër, që thamë, me përkujdesje janë të tilla dhe do të zhvillohen edhe në qendrat tjera.

Lidhur me të dhënat që ju i kërkuat, janë të dhëna të punuara së bashku me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe prevalencat e larta të çrregullimit të stresit post-traumatik. Këtu, në vendin tonë konsiderohet që janë diku 22% të distresit emocional janë shumë të larta, janë 43.6% dhe depresioni vlerësohet diku në 41.8% në popullatën...

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti ministër! Sipas statistikave, këto janë të gjitha ato të cilat janë nëpër qendra rehabilituese. A keni statistika për ata të cilët janë të mbyllur me vite të tëra dhe për shkak të mentalitetit, njerëzit nuk i ofrojnë pranë këtyre qendrave?

KRYETARI: Vazhdo, ministër!

ALUSH GASHI: Ka të dhëna të cilat janë të mbledhura nga ekspertë të vendit, ku pas këtij organizimit të ri, i cili është për gjashtë- shtatë vjet të fundit, për një numër të pacientëve të cilët me vite kanë qenë të mbyllur në familjet e tyre, pas kësaj pune në shtëpitë integruese ata kanë filluar t'i kthehen jetës, dhe një prej problemeve reale të vendit tonë, për një kohë shumë të gjatë, do të thotë edhe mbi një dekadë, është çështja e trajtimit të stresit, i cili është si pasojë e luftës dhe e gjendjes së pasluftës. Pra, për një çështje të tillë, ne duhet të jemi shumë të sinqertë dhe korrekt, nevojitet një qasje tjetër buxhetore ndaj shëndetësisë, e në veçanti ndaj kësaj fushe.

Kemi një numër të pacientëve, i cili ende është jashtë Republikës së Kosovës, nëpër shtëpi të azilit psikiatrik, por po ashtu, në Qendrën e Shtimes. Ekziston një numër i pacientëve, i cili është jashtë Republikës së Kosovës dhe neve në këtë proces na nevojitet një mbështetje buxhetore shumë më e fuqishme se sa kemi arritur sot.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Shpresa Murati, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsjedniče!

Uredbom broj 2006/14 o proglašenju Zakona o Radioteleviziji Kosova, članom 20 tačka 11, predviđja se da 5% sredstava od prikupljene javne pretplate za emitovanje programa upućuje u fond osnovan pri kabinetu Premijera za podršku manjinskim multietničkim i ugroženim medijima. Međutim, nijedan manjinski medij u 2007.godini, a kraj je 2008. godine, nije dobio ta sredstva.

Iako su mediji na bosanskom, turskom i romskom jeziku u teškom položaju, kada ne postoji nijedan pisani medij na ovim jezicima, u poslednje vreme ne dobijamo ni ono što je zakonom predviđeno.

Gospodine premijeru, zašto se ne sprovodi zakon i šta ćete preduzeti u budućnosti da bi se zakon sprovodio na pravi način i manjinski mediji budu podržani kako i zaslužuju. Hvala!

KRYETARI: Zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit deputete, Shpresa!

Fillimisht, dëshiroj që të sqaroj me sa vijon rreth çështjes që ju e ngritët. Ligji për RTK nuk ka paraparë instrumente të nevojshme që rregullojnë procedurat e derdhjes së mjeteve nga parapagimi për RTK në Fondin e mbështetjes së mediave minoritare, multietnike dhe të grupeve tjera të veçanta. Prandaj, nisur nga kjo situatë, Zyra e Kryeministrit ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me RTK, i cili i rregullon procedurat e zbatimit të ndarjes së 5% të mjeteve të parapagimit për RTK në Fondin për mbështetjen e mediave minoritare, multietnike dhe të grupeve tjera të veçanta. Kjo marrëveshje ka filluar të zbatohet që nga periudha para dy vjetësh. Fondit deri tani i ka munguar Rregullorja e punës, si akt juridik që do të rregullonte funksionimin e tij. Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e 46 të saj të mbajtur më datë 3.12.2008, ka miratuar Rregulloren e Fondit për mbështetjen e mediave minoritare, multietnike dhe të grupeve tjera të veçanta.

Në ditët në vijim, deri në fund të këtij viti, do të konstituohet një komision i pavarur, i cili do të udhëheqë Fondin dhe më së largu deri në janar do të publikohet konkursi për përfitimin e grandeve nga ky fond. Konkursi do të jetë i hapur për të gjitha mediat minoritare dhe të gjitha ato do të arrijnë të dëshmojnë se janë në shërbim të komunitetit të vet, do të përfitojnë nga ky fond. Qeveria e Kosovës do të vazhdojë që me përkushtim dhe prioritet t'i trajtojë nevojat kulturore dhe të informimit në gjuhën amtare për të gjitha komunitetet në Kosovë. Në këtë funksion, do të ofrojë edhe përkrahjen e merituar për t'i realizuar të drejtat e tyre qytetare dhe etnike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit Kryeministër!

Deputete, a keni pyetje shtesë? Faleminderit deputete!

Pyetja e radhës. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e MTI- së, zotin Lutfi Zharku. Deputet, paraqit pyetjen!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kam një pyetje për çmimin e naftës edhe pse vetë eci në këmbë. Sidoqoftë, ka kohë që çmimi i naftës është duke rënë në vazhdimësi. Që nga korriku i sivjetmë, kur çmimi arriti kulmin prej 147 dollarë e 27 cent për barelë, tashti dje pasdite barela kushtonte 40 dollarë. Ulja është drastike për më shumë se 3.6 fish më lirë, por një ulje të tillë konsumatori kosovar nuk po e shijon. Përshtypja është se importuesit e naftës, duke shfrytëzuar fuqinë oligopoliste të tyre në treg, janë marrë vesh mes veti për ruajtjen e çmimit në treg. Siç e dini, zoti ministër, këso lloj marrëveshjesh apo këto praktika që janë në kurriz të konsumatorit, janë të padëshirueshme dhe të palejuara gjithkund, e po ashtu edhe në Kosovë janë disa rregulla që nuk e lejojnë këtë praktikë. Pyetja është: - Çfarë ka ndërmarrë Qeveria deri më tash dhe kur mund të presin konsumatorët kosovarë që kjo grabitje apo kjo rrjepje çmimesh të stopohet? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Zoti ministër, fjala është juaja.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar Kryetar, Kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Ligji 2004/36 për konkurrencën, me nenin 3 përcakton se marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimi i një shoqate të ndërmarrjeve ose i një praktike të bashkërenduar e ndërmarrjeve është e ndaluar, nëse mund të ndikojë në tregtinë brenda Kosovës, ka për qëllim të saj ose mund të ndikojë në mënyrë të dukshme në parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konkurrencës në vend. Kjo ndalesë në mënyrë specifike zbatohet, ndër të tjera edhe për një marrëveshje, vendim ose praktikë që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përcakton çmimin shitës ose blerës ose çfarëdo afati apo kushti tjetër në tregti ose biznes. Dyshimet e ngritura nga ana juaj si importues të naftës kanë marrëveshje në mes tyre për ruajtjen e çmimit në treg, që nënkupton se kemi të bëjmë me një marrëveshje monopoliste, janë në kompetencë dhe duhet të shqyrtohet nga Komisioni kosovar i konkurrencës, në bazë të ligjit 2004/36 për konkurrencën. MTI, në bazë të autorizimit të marrë nga Qeveria, ka kryer të gjitha procedurat ligjore për përzgjedhjen e anëtarëve të këtij komisioni, kurse Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të 7 nëntorit 2008, ka bërë emërimin e anëtarëve të këtij komisioni. Mbledhja e parë inauguruese e Komisionit të konkurrencës është mbajtur më 4 dhjetor 2008 dhe tanimë është funksional. MTI është duke punuar në krijimin e kushteve sa më të mira teknike që ky komision t'i fillojë shqyrtimet e rasteve, siç është ky i ngritur nga ana juaj. Përndryshe,

mund të konfirmoj se ne në MTI nuk kemi kurrfarë dëshmie, në bazë të cilës do të fillonim ngritjen e procedurave apo shqyrtimin e ndonjë rasti. Sa i përket anës tjetër, Ligji për tregtinë e brendshme në mënyrë decisive ndalon intervenimin në treg, megjithëkëtë ne kemi dorëzuar në Qeveri, Qeveria, javën e ardhshme me siguri do të shqyrtojë ndryshimin e Ligjit për tregtinë me naftë, me të cilin kemi paraparë edhe mundësinë e intervenimit në treg në rastet që ju i cekni. Momentalisht, korniza ligjore nuk na lejon një intervenim të tillë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar, edhe një gjysmë komenti. Më vjen mirë që zoti ministër dha një përgjigje, po them përgjigjen më të mirë që kam marrë deri tani, më profesionale ndonjëherë në këtë Parlament nga kjo Qeveri. Është për t'u përshëndetur, po megjithatë do t'i propozoja ministrit që të angazhohet pak më shumë në krijimin e rezervave shtetërore, të cilat pastaj do të mund t'i përdorte për këto rastet urgjente. Sa u përket dëshmime, dëshmitë ekzistojnë te çmimi, zoti ministër, më gjithë respektin. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti deputet, faleminderit!

Javën e kaluar Qeveria ka kaluar, ka marrë vendim për Projektligjin për rezervat shtetërore dhe atë do ta keni në Parlament, me siguri gjatë janarit, besoj, kurse pasi jam këtu, deputeti Smaka e ka bërë të njëjtën pyetje, përafërsisht të njëjtën pyetje, unë e kam bërë gati edhe me shkrim për t'ua dërguar dhe ua dërgoj pa kurrfarë problemi.

(Ndërhyrje – flet pa kyçje të mikrofonit)

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Megjithatë, faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e radhës. Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin apo ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputet, mund ta bëni pyetjen!

RIZA SMAKA: I nderuar Kryetar,

Të nderuar qeveritarë, deputetë,

Pikërisht në 60- vjetorin e miratimit të Konventës së OKB-së për krime lufte dhe gjenocid, e kam ngritur këtë pyetje, e cila i referohet Qeverisë - pse nuk e ngrit aktpadinë kundër shtetit serb në Tribunalin Ndërkombëtar të Drejtësisë në Hagë? Arsyeimi është mjaft i gjerë, është fjala për shkelje drastike të Konventës së Gjenevës për Krime të Luftës dhe Gjenocid, për dëme materiale, morale dhe krime lufte kundër popullit civil të paarmatosur të Republikës së Kosovës. Përderisa shteti serb di të na padisë neve për një kishë politike të ndërtuar në parkun e qytetit, po e zëmë, në Gjakovë, ndërsa 300 kulte fetare janë shkatërruar në Kosovë. Mendoj se do të duhej okulio pro okullum....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjala është për ministren. Ministre Kelmendi, e keni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Përshëndetje për ju, Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët e pranishëm!

Faleminderit zoti Smaka për pyetjen që e keni shtruar!

Çështja e krimeve të luftës, përkatësisht çështja e krimit e gjenocidit është një çështje që asnjëherë nuk e ka marrë formën e duhur në Kosovë. Domethënë, nuk është gjykuar askush prej Tribunalit Ndërkombëtar për Krime të Luftës për këtë vepër, por as nuk është ngritur padi në Tribunalin Ndërkombëtar të Drejtësisë në Hagë për t'u konstatuar se në Kosovë ka ndodhur gjenocidi. Tani kur Serbia ka nis iniciativën në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës për t'u konstatuar se është e pavlefshme shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe ai Tribunal e ka pranuar atë iniciativë, konsideroj se edhe pse nuk jemi anëtare e Kombeve të Bashkuara, neve na është pranuar statusi i palës në atë Tribunal. Po kështu, edhe statuti i Tribunalit në fjalë e parasheh që palë në procedurë mund të jenë edhe ato palë të cilat nuk janë anëtare të Kombeve të Bashkuara. Si Ministri, jemi të gatshëm që ta formojmë grupin dhe ta ngremë padinë në Tribunalin e Hagës kundër Serbisë për t'u konstatuar se këtu në Kosovë është bërë gjenocid, pikërisht nga forcat policore ushtarake të Serbisë dhe eprorët më të lartë të saj, mirëpo nevojitet një vendim politik dhe më pastaj ne do të ecim përpara. Nëse keni pyetje shtesë, jam e gatshme të përgjigjem.

KRYETARI: Faleminderit, ministre. Deputet, keni pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Është parim juridik ndërkombëtar valid aplikativ që pala e dëmtuar kurdoherë ka të drejtë të ankohet, të padisë në këtë rast. Prandaj, unë do të isha angazhuar që të ngrihet aktpadia dhe ajo do të ishte instrument, ndër të tjera, edhe për relaksim të raporteve reciproke që janë aq të nevojshme ndërmjet shtetit kosovar dhe atij serb. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Mirë, ministre, ne do të vazhdojmë. Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministri nuk është këtu. A do të më përgjigjet njëri nga zëvendëskryeministria? Nuk donë, a po? Atëherë, e lë për seancë të radhës ose, nëse kthehet Kryeministri. Faleminderit!

KRYETARI: Po presim, pra. Vazhdojmë! Faleminderit, deputete!

Deputetja Myfera Shinik, pyetje për ministrin e Ministrisë së Ambientit, të Planifikimit Hapësiror, zotin Mahir Yagcillar. Deputete, mund ta bëni pyetjen. Regjia, fjalën deputetes Myfera Shinik.

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim sayın başkan, bakanlar, milletvekilleri

Kosovada ister yerleşim yerlerinde, ister dışında baz istasyonlarının günden güne artığını görmekteyiz. Bu baz istasyonlarının kurulması için izin verilmesi tartışılacak bir konu olduğunu düşünüyorum. Bunun için sayın bakanımıza şu soruyu yöneltmek istiyorum.

Bu konuda Siz Alan ve Çevre Bakanı olarak ne gibi önlemler alıyorsunuz.
Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILLAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryetar, e nderuara kryesi, të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, deputetë, sayın milletvekili Müfera Şinik hanımefendi. Sorunuz için öncelikle teşekkür etmek isterim, ancak konunun kamuoyuna önemli olduğundan dola, izninizle cevabı Arnavutça vermeji istiyorum.

Pëlqimi mjedisor, si akt i parë, jepet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sipas Udhëzimit Administrativ 09/2004 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili se shpejti do të shndërrohet edhe në ligj për vlerësimin e ndikimit të mjedisit, i cili është në fazën e miratimit në Kuvend. Lokacionin e përcakton investitori, në këtë rast te ne janë” IPKO” dhe “Vala 900”, ndërsa lejen urbanistike e jep organi kompetent i komunës. Në rast se janë objekte me rëndësi për vendin, lejen urbanistike prapë e jep Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, sipas ligjit të ri të planifikimit hapësinor. Deri më tash janë dhënë 201 pëlqime mjedisore për” IPKO” komplet, me kusht, me vendimin e sekretarit prej vitit 2007 për kompletimin e procedurës complete. Gjithashtu, kompania “Vala 900” ende, ndoshta, nuk e ka kompletuar – plotësuar dokumentacionin, por ekziston një pëlqim parimisht prej vitit 2005-2006. Sa iu përket matjeve, pajisjet janë të prodhuara sipas standardeve evropiane. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është në bisedime me Institutin e Mjekësisë së Punës dhe Universitetin ose, saktësisht, me Fakultetin e Elektroteknikës për matjen e rrezatimit, ku pritët shumë shpejt të nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit. Instalimi i pajisjeve kërkohet të bëhet konform kërkesave të Komisionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimi jonizues dhe Organizatës Botërore për Shëndetësi. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vendim e ka përcaktuar, gjithashtu, largësinë e vendosjes së këtyre stacioneve, minimum 15 metra nga objektet e banimit, sipas standardeve evropiane. Gjithashtu, dëshiroj t’ju përkujtoj se Projektligji për mbrojtje nga rrezatimi jonizues, jonizues dhe siguri nukleare....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, a keni pyetje shtesë? Faleminderit, edhe prej juve!

Pyetja e radhës është e deputetes Myrvete Pantina, për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Ministri nuk është këtu. A doni ta lexoni pyetjen? Urdhëroni, deputete!

MYRETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë nuk e di pse në regjistër nuk figuron emri edhe i ministrit Lutfi Zharku, meqenëse unë pyetjen e kam parashtruar për ministrin Zharku dhe për ministrin Vehapi, prandaj, nëse ministri Zharku është i gatshëm të përgjigjet në pyetje, unë do ta lexoj. E kam dëshminë!

KRYETARI: Unë po besoj, por ministri thotë se nuk e ka marrë pyetjen, kështu që e lëmë për seancën e radhës. Faleminderit, deputete!

Deputeti Enis Kervan, pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq. Deputet, e keni fjalën!

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Sayın bakan, 65 yaşını doldurmamış vatandaşların büyük bir çoğunluğu Kosova Cumhuriyeti dışındaki farklı ülkelerden emeklilik maaşı veya maddi sosyal yardım alıyorken, bu kişilerin çoğu eş zamanda Kosova Cumhuriyeti bütçesinden de emeklilik maaşı veya maddi sosyal yardım almaktadır. Diğer taraftan gerçekten maddi sosyal yardıma ihtiyacı olan, ne Kosova Cumhuriyetinden ne de dışından hiçbir maddi destek görmeyen henüz 65 yaşını doldurmamış ancak sağlık durumları nedeniyle vazife malulü olan vatandaşlarımızın sayısı da az değildir. Sayın Bakan, vatandaşların bu konudaki ağlaşılarını gaz önünde bulundurarak, ihtiyac sahibi diğer kişilerin sayılarında artış sağlamak maksadıyla, daha elverişli koşulların yaratılması konusunda bakanlığınızın rolü ne olacaktır ve Kosova dışındaki hiçbir ülkeden emekli maaşı almadıkları gibi maalesef Kosova bütçesinin....

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Ministri nuk e ka pasur pyetjen, do të thotë, përgjigja do të bëhet në seancën e radhës. Faleminderit!

Deputetja Dritë Maliqi, pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, mund ta bëni pyetjen.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëndetje për të gjithë!

Zoti ministër, kohëve të fundit jemi dëshmitarë të rritjes enorme të dhunës në shkollë, si dhe të dukurive të tjera negative si: konsumimi i duhanit, i narkotikëve, prezenca e armëve dhe këto dukuri për ne janë shumë shqetësuese. A mendoni se angazhimi i psikologëve në institucionet tona arsimore është nevojë e kohës dhe a keni projekt konkret për angazhimin e tyre në mënyrë që të parandalohen dhe evitohen këto fenomene tejet shqetësuese? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Shumë të respektuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Nga viti shkollor 2009/2010, ne planifikojmë që të punësojmë në të gjitha shkollat e Kosovës psikologë, të cilët janë shumë të domosdoshëm, së bashku me pedagogët në shkollë. Më lejoni t'ju informoj që deri më tash ka qenë pothuaj problematike rritja e numrit të punëtorëve në arsim, meqë punëtorët e arsimit janë trajtuar si shërbyes civilë, paralelisht me rritjen e numrit të psikologëve dhe të pedagogëve të cilët në disa shkollë ekzistojnë, po në disa të tjera jo. Ne u kemi sugjeruar kuvendeve komunale, komunave të Kosovës që ta shohin mundësinë e blerjes së shërbimeve për mirëmbajtje të shkollës dhe do të na krijoheshin vende të lira të punës në komuna, me qëllim që komunat thjesht të punësojnë sa më shumë psikologë. Kur është fjala e pyetjes tuaj, përveç përgjigjes direkte, unë do të bëj përpjekje që të jap edhe dy përgjigje tjera. Së pari, dhuna në shkollë si fenomen manifestohet në tri forma. Është një pjesë e dhunës, e cila është e projektuar jashtë shkollës, është një pjesë e dhunës se cila ndodh në mes nxënësve në shkollë dhe,

po ashtu, shpeshherë ka dhunë në mes nxënësve dhe arsimtarëve ose arsimtarët me nxënës. Ne jemi të interesuar që përmes strategjisë për parandalimin e dhunës në shkolla së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me planin e veprimit, ku në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës të zhvillojmë debate në të gjitha qytetet dhe me disa shkolla nga janari i këtij viti, po ashtu, të fillojmë ta adresojmë një çështje të tillë. Pjesa tjetër e pyetjes ka të bëjë me atë që thirret “shkollat e shëndetshme”. Kur është fjala për narkotikët në shkolla, ne kemi një strategji për “shkollat e shëndetshme”, e kemi një grup ndërmintor dhe jemi të interesuar që jo vetëm ta parandalojmë përdorimin e duhanit dhe të narkotikëve, por jemi po ashtu të shqetësuar me praninë e strabizmit në mesin e nxënësve, të karriesit në mesin e nxënësve, kështu që në janar po ashtu do ta kemi një javë e cila do të jetë java për “shkollat e shëndetshme”, e cila realisht do të synojë që të adresojë këtë problem, i cili edhe për ne si Ministri e Arsimit është shumë shqetësues.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Nuk keni pyetje, faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe të Sporteve, zotin Valton Beqiri. Deputet, paraqit pyetjen!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër, kultivimi i vlerave të mirëfillta kulturore dhe artistike, duke përkruar me identitetin kulturor e kombëtar dhe civilizues në Kosovë, tani edhe shtet i pavarur, duhet të ketë rëndësi dhe kujdes të veçantë në kuadër të prioritetëve të përcaktuara. Për këtë qëllim, në vitin 2007 është zgjedhur edhe fituesi i projektit ideor për ndërtimin e objektit të Teatrit të Operës dhe të Baletit “Ibrahim Rugova”. Pyetja ime është, zotëri ministër: - Në cilën fazë të implementimit gjendet ky projekt dhe cilat janë shkaqet që po kalon edhe viti 2008 dhe ende nuk keni filluar së implementuari këtë projekt të rëndësishëm?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI VALTON BEQIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se zhvillimi i infrastrukturës është më se i rëndësishëm për të gjitha institucionet tona të kulturës dhe në këtë bën pjesë edhe ndërtimi i objektit të Teatrit të Operës dhe të Baletit “Ibrahim Rugova”.

Bazuar në kontratën ekzistuese të fituesit të tenderit, pra nuk ka qenë e përcaktuar saktësisht data e përfundimit të projektit final dhe ne deri më tani kemi pasur dy prezantime të kompanisë fituese, kur kemi mbledhur ekspertët vendorë, të cilët kanë bërë shqyrtimin e projektit të propozuar dhe në bazë të dy prezantimeve kemi ardhur në konstatim se projekti final ende nuk është i gatshëm dhe nuk është i implementueshëm. Dhe, obligimi i projektuesit është që deri në fund të këtij viti ta sjellë projektin final. Ndërkohë, kanë munguar edhe disa leje nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, të cilat janë siguruar dhe po ashtu në buxhetin e vitit 2009 në vlerën, pra në Kodin buxhetor për investime kapitale, kemi siguruar 1 milion euro për vazhdimin dhe implementimin e këtij projekti. Dua të theksoj para jush, të nderuar deputetë, se në bazë të obligimeve tona, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Kulturës participojnë me 15% të vlerës së përgjithshme të ndërtimit të objektit, prandaj ne jemi në fazën dhe situatën kur kemi nevojë të gjejmë donatorë dhe investitorë të mundshëm. Jemi në pritje të funksionalizimit të Ligjit për koncesione nga ky Kuvend dhe shpresojmë se do të hapen mundësi të reja që

ne bashkërisht të gjejmë edhe investitorë të huaj që do të jenë të interesuar të investojnë në këtë projekt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë? Nuk ke. Faleminderit!

Armend Zemaj, pyetje për ministrin e Punës, Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq. Ministri konfirmon se nuk e ka marrë pyetjen. Pra, e lëmë për seancën e radhës, ose nëse do, lexoje pyetjen!

ARMEND ZEMAJ: Unë po ia lexoj, sepse ky duhet ta dijë përmendësh këtë pyetje.

KRYETARI: Pra, lexoje, nëse është i gatshëm, pastaj përgjigjet.

ARMEND ZEMAJ: Zoti ministër, pasi që s'e paske marrë pyetjen, në Kosovë sipas evidentimeve të bëra nga shumë organizata joqeveritare që merren me të drejtat e fëmijëve, fëmijët u janë nënshtruar punës apo punëve më të ndryshme, e në raste të veçanta edhe shumë të rënda dhe të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e tyre, duke punuar në ndërtimtari, grumbullim të hekurishtës, pastrues plehrash, hamaj në treg, bujqësi, e tjera. Shumë herë kjo, zoti ministër, është shfrytëzuar nga biznesmenët e papërgjegjshëm, duke shfrytëzuar edhe gjendjen sociale-ekonomike në vendin tonë. Pyetja ime konkrete është: - Çka keni ndërmarrë ju dhe Ministria që drejtoni, për parandalimin dhe eliminimin e këtij fenomeni abuziv të punës me fëmijë dhe i cili është në rritje çdo ditë e më shumë?

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Ministri s'e ka marrë pyetjen. Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotin Valton Beqiri. Deputet, mund ta bëni pyetjen!

ARMEND ZEMAJ: Duke marrë parasysh se studentët të cilët studiojnë në universitetet tona të Kosovës dhe të cilët janë në numër jo të vogël dhe me kushte jo të mira materiale, ku burim të vetëm të financimit kanë buxhetin familjar dhe mundësia e punësimit sezonal në vendin tonë është shumë e kufizuar për t'u angazhuar gjatë pushimeve semestrale, Ministria që ju drejtoni është kompetente për përkujdesjen dhe zhvillimin e politikave rinore që shkojnë në të mirë të zhvillimit të rinisë në përgjithësi. Pyetja ime: - A keni ndonjë plan-program apo ndonjë marrëveshje për studentët kosovarë për punë sezonale gjatë pushimeve semestrale në vendet e zhvilluara, konkretisht, për studentët e universiteteve tona?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

VALTON BEQIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

T'ju informoj se as pyetjen paraparake, as këtë pyetje nuk i kam pasur paraprakisht, por natyrisht e kam obligim të jap përgjigje, aq sa kam informata momentale. Çështja, pra shqetësimi i rinisë kosovare përgjithësisht është punësimi, ndër të tjera, arsimimi, shëndetësia, por punësimi është një çështje e cila është evidentuar si më prioritare në gjithë rininë kosovare. Në kuadër të politikave tona programore, ne mundohemi që të gjejmë forma të bashkëpunimit dhe të stimulimit të veprimtarisë sonë, gjegjësisht të rinisë sonë, të angazhimit të tyre në vendet e Evropës, përgjithësisht. Edhe pse jemi në koordinim me Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, meqenëse është një obligim i përbashkët yni për ta zgjidhur këtë çështje, ne mund t'u tregojmë se në bashkëpunim me Agjencionin Federal të Punës nga Qeveria gjermane, kemi siguruar që 200 deri 220 të

rinj, gjatë këtij viti, pra gjatë vitit të ardhshëm 2009, të marrin pjesë, në punët e ndryshme sezonale në shtetin e Gjermanisë. Fatmirësisht, konkursi është ende i hapur, por është i hapur deri me datën 22 dhjetor dhe mund të aplikoni në portalin qeveritar, gjegjësisht në Ministrinë e Kulturës dhe deri tani kanë aplikuar rreth 350 të rinj. Ne shpresojmë se edhe një defekt, edhe një problem i sigurimit të vizave do të eliminohet në të ardhmen, meqë e dimë se edhe çështja e vizave është çështje problematike, e cila duhet diskutuar, do të thotë, duhet zgjidhur dhe shpresojmë se në të ardhmen në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale do të ofrojmë mundësi sa më të mëdha të punësimit sezonal në shtetet e Evropës.

Të gjithë e dimë se ata janë të interesuar t'i marrin në punë njerëzit e rinj, prandaj çfarëdo kontrate dhe çfarëdo marrëveshje që do të bëjë edhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, do të jetë në favor të rinisë, sepse Evropa është e interesuar për forcën e rinisë sonë, prandaj besoj se ata do të kenë përparësi në këtë rast.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Nait Hasani, pyetje për ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Skënder Hyseni. Deputet, e keni radhën për pyetje!

NAIT HASANI: Ju faleminderit, Kryetar!

Për herë të dytë e parashtroj pyetjen. E kam regjistruar në protokoll më 17.10. 2008. Pra, më vjen mirë që erdhi para Vitit të Ri se ka mund të vijë edhe në vitin 2009.

Çështja: - Lëshimi i pasaportave diplomatike, duke mos e cekur shtetasin, në bazë të rregullores gjyqësore, dhe emërimit të vendeve, sipas kodifikimit të "Fjalorit të gjuhës shqipe" ku përcakton rregullat e drejtshkrimit të vendeve dhe emërimin e vendeve.

Pyetja: - A është konsultuar "Fjalori i gjuhës shqipe" në lëshimin e pasaportës me emërtimin kosovar, në vend të emërimit Kosovë. E, për ju, a nënkupton banorin kosovar, apo shtetasin e Kosovës? Pra, ne a jemi shtetas të Kosovës apo shtetas kosovar?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar deputet Nait Hasani,

Më lejoni që së pari t'ua përkujtoj se të gjitha llojet e pasaportave nxirren në bazë të Ligjit për shtetësinë dhe prodhohen nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme vetëm se përpunon aplikacionet, në këtë rast pasaportë diplomatike.

Gjithsesi, përmbaja e pasaportave, qofshin ato diplomatike ose të tjera, është rregulluar me Ligjin për shtetësinë, të miratuar nga ky Kuvend dhe është operacionalizuar me akte nënligjore që burojnë nga ky ligj që është miratuar në këtë Kuvend.

Kjo, domethënë, që sipas legjislacionit në fuqi, duke e përfshirë edhe Kushtetutën e Kosovës, që është akti më i lartë juridik i vendit, banorët e Kosovës emërtohen shtetas të Republikës së Kosovës. Pra, me këtë saktësohet përkatësia, përkatësisht shtetësia e jo

përkatësia etnike. Nuk kemi të bëjmë me përkatësi etnike, domethënë. Ky parim vlen jo vetëm për pasaporta diplomatike, por vlen edhe për pasaportat e Shërbimit dhe ato të zakonshme.

Unë nuk e pata asnjë shqetësim dhe problem që të përgjigjem në pyetjen tuaj dhe e mirëpres, natyrisht, por pyetja ka mundur të adresohet edhe te Ministria e Punëve të Brendshme. Gjithsesi, ju falënderoj për pyetjen.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

NAHIT HASANI: Ju faleminderit ministër! Pasaportën na e keni lëshuar ju, për atë iu drejtova juve. Por pyetje shtesë për mua është, meqë në Kosovë jetojnë 90% shqiptarë, a ka shqiptarë në Kosovë, apo jo?

KRYETARI: Ministër, do të përgjigjesh?

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Natyrisht, u tha që Kushtetuta e saktëson atë që është përkatësi shtetërore, përkatësisht shtetësi dhe, po ashtu, e saktëson qartë çka është përkatësi etnike.

Zoti deputet, ju iu referuat edhe “Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe.” Nëse e hapni, ju do të gjeni atje që kosovar definohet si banor, vendas i Kosovës, që vjen nga Kosova, që ka të bëjë me Kosovën dhe, në fund të fundit, unë prapë po e përsëris, Ministria e Punëve të Jashtme i përpunon aplikacionet për pasaporta diplomatike dhe, të gjitha të dhënat në pasaportë diplomatike, tash po thellohem më tutje, janë në gjuhën angleze dhe te shtetësia, rubrika ku kërkohet shtetësia, përgjigja është në gjuhën angleze dhe nuk ka asnjë mënyrë tjetër të jepet përgjigja në këtë pyetje në gjuhën angleze, pos ashtu siç është në pasaportë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Jo, nuk bën koment. Pyetjet parlamentare dihet si bëhen, të mos dalim tash prej rendit të ditës, jemi në debat këtu, keni parasysh.

Pyetja e fundit për sot. Deputetja Sala Berisha- Shala, pyetje për ministrin e Ministrisë për Tregti, Industri, zotin Lutfi Zharku.
Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje për të gjithë,
Zoti Ministër, në kuadër të programit - Hapësirat e punës si promovim i ndërmarrësisë, në një nga programet thelbësore të Ministrisë suaj, mbështetje të ndërmarrjeve private në Kosovë, që si qëllim ka pasur ngritjen e kapaciteteve konkurruese, si dhe për atraktivitetin e investimeve të mundshme nga jashtë në vitin buxhetor 2005-2006, Ministria ka vendosur të themelojë një park industrial në pjesën qendrore të Kosovës, përkatësisht në Korriticë të Drenasit.

Parku Industrial në Drenas, si një nga projektet e Ministrisë suaj, në bashkëpunim me komunën, është menduar si promotor i zhvillimit rajonal të Drenicës, i cili në qoftë se do të realizohej, do të gjeneronte vende të punës dhe të ardhura.

Pyetja është: -Në cilën fazë ndodhet projekti, sa për qind është realizuar dinamika e planifikuar e zhvillimit të punimeve?

KRYETARI: Zoti ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuari Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

E nderuara deputete,

Programi - Hapësirat e punës, është një program zhvillimor i miratuar nga MTI-a, pas hulumtimeve dhe analizave të shumta që janë bërë me sektorin e NMV-e dhe në përgjithësi në sektorin privat në Kosovë.

Këto hulumtime kanë treguar se rreth 30% të të gjitha investimeve, bizneset tona i derdhim në ndërtimin e infrastrukturës fizike, si: rrugë, energji, kanalizim, etj.

Programi -Hapësirat e punës, përfshinë projekte të cilat mbështesin dhe inkurajojnë themelimin dhe shtimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të reja, si inkubatorë të biznesit, që tani i kemi tre të tillë, në Deçan, Gjilan dhe Shtime, si dhe parqe të biznesit ai i Mitrovicës dhe, natyrisht, projekti më kapital i MTI-së, siç është parku i biznesit në Drenas.

Në këtë park parashihet të vendosen rreth 72 kompani nga sektorë të ndryshëm, prodhues e shërbyes dhe parashihet hapja e së paku 1000 vendeve të reja të punës.

Parku i Biznesit do të jetë pjesë e rëndësishme e një zone industriale prej 130 hektarësh, e cila tani ka hyrë në agjendën e MTI-së dhe në linjën buxhetore të saj për zhvillim.

Në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm, si dhe për shkak se është një projekt inovativ dhe pionier në gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, implementimin dhe ekzekutimin e punëve në këtë projekt, jo rrallë e kanë përcjellë edhe vështirësi.

Sivjet jemi duke punuar në fazën përfundimtare në krahun lindor. Duhet cekur se ekzekutimi i punimeve në këtë park nuk është formulë e lehtë. Në këtë park jemi duke vendosur gjithë infrastrukturën moderne, duke ofruar te çdo ngastër veç e veç kyçje në kanalizim fekal dhe atmosferik, rrjetin e ujit të pijshëm dhe të ujërave industriale, rrjetin e gazit, rrjetin e nxehjes qendrore, rrjetin e ndriçimit publik, rrjetin e furnizimit me rrymë elektrike kualitative, atë të telefonisë dhe rrjetin optik. Përkthyer në shifra, deri në kohën kur po raportojmë, nga 1.800.000 mijë euro sa qenë ndarë për këtë vit të buxhetit, punët janë kryer dhe janë paguar për 1 milion 530 mijë apo 85% të punëve janë kryer.

Nga shuma e kontraktuar për këtë vit, vetëm afër 270 mijë euro do të mbesin për vitin e ardhshëm, që e gjitha ka të bëjë me shtrimin e asfaltit. Për vitin e ardhshëm, për vitin 2009, ne kemi planifikuar një buxhet prej afër 3,5 milionë , ku janë të ndara 500 mijë euro të cilat shpenzohen në finalizimin e punimeve të këtij parku, 1,5 milionë nga projekti për 6 milionë për lidhjen në rrjetin kryesor energjetik, 1 milion për dërgimin e rrjetit të ujësjellësit, si dhe 500 mijë euro për fillimin e punimeve në zonën industriale.

Dua t'ju njoftoj se MTI, bashkë me komunën e Drenasit, si aksionarë të vetëm, kanë të themeluar një bord të projektit që përbëjnë nga përfaqësues të MTI-së dhe komunës, i cili bord mbledhet rregullisht për ta shqyrtuar progresin që ndodh në këtë projekt. Ne, mbledhjen e radhës e kemi pasur sot në mëngjes.

Bordi shumë shpejt do t'i miratojë politikat operationale të aplikimit, ndarjes dhe të funksionimit, si dhe shumë shpejt të do hapë konkurs ndërkombëtar për kompanitë që janë të interesuara të vendosen në këtë park.

Sipas parashikimeve tona, ne besojmë se në pranverën e vitit...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputete ke pyetje shtesë?

SALA BERISHA- SHALA: Nuk kam pyetje shtesë, por mora dhe përgjigjen që e pata në plan t'ia bëjë se sa respektohet Memorandumi i Bashkëpunimit në mes komunës dhe Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë. Dinamika e këtyre punëve është shpërfillur dhe është zvarritur qëllimisht nga Qeveria e kaluar. Dihet se ky park e ka një afat kohor kur është dashur të realizohet, prandaj, sigurisht që Ministria dhe Qeveria do t'i bartin pasojat e veta, meqenëse ne jemi dëshmitarë se bizneset thuaja se janë depozituar, janë stacionuar në vendet tjera, kështu që unë jam shumë skeptike të besoj se do të realizohet qëllimi përfundimtar i parkut në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Do të thotë, me këtë koment është mbyllur pika e dytë e rendit të ditës. Pa kaluar në pikën e radhës, deputetja Gjylnaze Syla ka kërkuar fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kam bërë pyetjen më 30 dhjetor 2008, për ministren Pula dhe pyetja ka qenë, ku është kërkuar përgjigja me gojë. Meqenëse nuk e pash këtu në kalendarin, as të nëntorit, as të dhjetorit, kërkoj sqarime pse s' ka ngjarë kjo, kështu që kjo pyetje atëherë të kalohet në vitin e ardhshëm, në vitin 2009, mbase do të jetë ministrja këtu të përgjigjet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ne, në një seancë më parë, kemi marrë vendim që të gjitha pyetjet të muajit tetor dhe nëntor, që nuk janë lexuar, botohen në Buletin. Nëse doni përgjigje, mund ta përsëritni pyetjen, deputete!

Kemi një kërkesë nga Qeveria që pikën e 10-të të rendit të ditës ta fillojmë tani, megjithatë ne duhet ta bëjmë një votim formal.

Kush është që pika e 10-të të jetë pika e radhës? Ju faleminderit! A ka kundër? Me shumicë votash, do të thotë, pika e 10-të, bëhet pika e 3-të e rendit të ditës.

Në sallë janë 63 deputetë.

Qeveria e Republikës së Kosovës është në pajtim që pika e 10-të bëhet pika e 3-të e rendit të ditës. Fjala është për:

- **Shqyrtimin e Propozimvendimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave tatimore.**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Administratën tatimore dhe procedurat, e ka proceduar për miratim në Kuvend listën e kandidatëve për anëtarë të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave tatimore.

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Propozimvendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave tatimore dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Propozimvendimi i Qeverisë me dokumentacion dhe rekomandimi i komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Kryetari i komisionit funksional, Gani Koci, nuk e ka kërkuar fjalën. Atëherë, radha është te shefat e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e ka fjalën shefi i Grupit, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar dhe ju kolegë të nderuar deputetë, I nderuar zoti Kryeministër dhe Kabinet qeveritar, Ne, shefat e grupeve parlamentare, nuk e kërkuam fare fjalën për arsye se kjo është një procedurë që mund të votohet apo mos të votohet, është çështje e deputetëve, por ne si Grup Parlamentar kemi vendosur ta votojmë këtë bord. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Sabri Hamiti, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

SABRI HAMITI: Natyrisht që e kemi shqyrtuar në komisionin, në Grupin Parlamentar të LDK-së, këtë pikë të rendit të ditës, me seriozitetin që e ka, dhe do të procedohet votimi i këtij vendimi në Kuvend.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Zoti Kryeministër,
Të nderuar kolegë,
Grupi Parlamentar i AKR-së nuk ka ndonjë qëndrim të plotë për këtë çështje. Do të jetë vullnet individual i deputetëve gjatë votimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i AAK-së nuk do t'i votojë kandidatët e propozuar nga Qeveria. Arsyeja është se, duke i lexuar CV-të e kandidatëve, kemi konkluduar se nuk ka pasur shikim paraprak se çka i duhet Kosovës, mirëpo ka pasur esencialisht shpërndarje të posteve për disa njerëz të cilët i janë dashur Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

Edhe njëherë në radhën e listave partiake joprofesionale dhe joserioze për borde tejet të rëndësishme për vendin, është edhe ky propozim i radhës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë do të votojë kundër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, nuk e ka kërkuar fjalën askush.

Në emër të SLS-së, jo.

Këtu e kam të lajmëruar deputeten Vezira Amrush. Nuk e di, nëse e keni kërkuar fjalën. Regjia, fjalën për deputeten Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala svima prisutnima, posebno vama gospodine Predsednice, za datu reč.

Ja sam se javila pvodom toga, da u ovoj preporuci Vlade, koja nam daje preporuku za imenovanje članova Nezavisnog borda za preispitivanje poreskih žalbi, imam primedbu da nema predstavnika ostalih nacionalnih manjina, što se dešava uporno kada nam Vlada prezentuje predloge za neke komisije.

Očekivala sam da će takvu primedbu da ima Grupa “7+”, ili SLS. Pošto se to nije desilo, ja dajem ovu primedbu. Hvala lepa!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Atëherë, vazhdojmë me procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota “për”, 20 “kundër”, 8 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët e Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave tatimore me mandat dy vjeçar, me këtë përbërje:

1. Skënder Kolgeci, kryesues,
2. Miftar Shala, anëtar,
3. Ramadan Sejdiu, anëtar,
4. Ekrem Kastrati, anëtar,
5. Osman Sadikaj, anëtar,
6. Luljeta Baraliu, anëtare dhe
7. Hajrush Beqiri, anëtar.

Pas kësaj pike, mendoj se është koha ta bëjmë një pauzë për kafe.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Zonja e zotërinj, ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë, edhe dy- 63, kështu që mund të vazhdojmë me seancën dhe pikërisht me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për rehabilitim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara dhe Kuvendi ia kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Ftoj raportuesen e Komisionit Funksional, zonjën Flora Brovina, për ta arsyetuar Raportin me rekomandime.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit!

Komisioni funksional ka shqyrtuar këtë projektligj dhe pas një debati të gjerë me të gjithë të interesuarit- janë personat me aftësi të kufizuar, shoqatat e tyre, ekspertët, pastaj shoqëria civile, vetë ministrinë që janë ftuar në debat, kanë nxjerrë këto amendamente që janë para jush edhe ne ju ftojmë që t'i votimi. Një amendament nuk është pranuar nga Komisioni. Ky është amendamenti numër 11, për arsye financiare, domethënë, sepse e ngarkon buxhetin dhe kemi kërkuar nga Ministria për Financa që të na përgjigjet a mund të na pranojnë apo jo? Përgjigja ishte se pranohen këto amendamente që i ka propozuar komisioni funksional. Ju faleminderit! Kërkoj nga deputetët që ta përkrahin këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina!

Këtë të drejtë kanë edhe kryetarët e komisioneve kryesore, në qoftë se dikush dëshiron të paraqitet për fjalë. Nuk po shohim që ka të paraqitur, kështu që, zonja e zotërinj, vazhdojmë tani me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Amendamenti 1 i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Kalojmë në amendamentin 3 .

Regjia dhe deputetë gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Ju njoftoj se në sallë janë 76 deputetë.

Kalojmë në amendamentin 4

Regjia dhe deputetë, gati për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Kalojmë në amendamentin 5.

Regjia dhe deputetët, gati. Votojmë tash:

Ju lutem, zotit Makolli jepjani fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Kam një vërejtje dhe paqartësi në amendamentin 5 dhe do t'i lutesha komisionit që ta sqarojë. Në të vërtetë, nëse e lexoni mirë këtë amendament, atëherë mund të kuptoni se s'keni kuptuar asgjë me te, prandaj do të ishte mirë që të na sqarohej se çka është menduar me këtë amendament?

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli!

A dëshiron dikush ta sqarojë? E ka fjalën zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Do ta shpjegoja, ju sigurisht jeni ngatërruar për shkak se vetë titulli, personi me aftësi të kufizuar për punë dhe personat me aftësi, domethënë ky i ka ngatërruar- vetë titulli, sepse ne nuk i quajmë më shkurt dhe ngatërrohet, ndoshta, kuptimi. Por, personi me aftësi të kufizuar mund të jetë për një kohë më të shkurtër 12 muaj, domethënë ose edhe më shkurt dhe në këtë kuptim, nuk po e di pse nuk e keni kuptuar? Ku është problemi? Mund ta lexojmë fjalë për fjalë edhe në qoftë se diçka nuk e keni të qartë.

Është i formuluar pak më ngatërrueshëm, por po ta lexoni fjalë për fjalë, e shihni që e kuptoni. Personi me aftësi të kufizuar për punë është personi me aftësi të kufizuar, aftësia e të cilit në raport me aftësinë e personit që nuk ka aftësi të kufizuar, pra është pa aftësi të kufizuar të moshës së njëjtë, po dua të them, me ne, sepse nuk mund t'i quajmë ndryshe, ose me aftësi dhe edukim të njëjtë ose të përafërt me kushte të njëjta të punës, ose të përafërta në punë të njëjtë ose të përafërt, ka si pasojë aftësinë e kufizuar të përhershme ose së paku 12 muaj mundësinë e zvogëluar për aftësim, mundësinë e zvogëluar të punësohet dhe të punojë në tregun e punës me kushte të përgjithshme dhe të barabarta. Është, domethënë, vetëm fjala që edhe ne quhemi persona, domethënë vetëm kjo është që po të ngatërrohet.

KRYESUESI: Zoti Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Në të vërtetë, e kisha shumë të pakuptueshme, tash e kam dyfish më të pakuptueshme këtë që u tha. Personi i aftësisë së kufizuar, i pakufizuar, të kufizuar dhe konsideroj se ashtu si ka qenë më përpara, është shumë më mirë se sa tash që është formuluar ky. Për shembull, unë do ta shtroja çështjen- pse 12 muaj, pse nuk mund të thuhet me aftësi të kufizuar të përhershme ose të përkohshme dhe pastaj rregullohet cilat janë? Por, kësisoj çfarë është ky amendament i propozuar, është absolutisht për të mos kuptuar pothuajse asgjë. Kjo që ka qenë më herët në draftligj, është shumë herë më e mirë se sa kjo që na është ofruar prej Komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli!

Zoti Sabri Hamiti, është paraqitur për fjalë.

SABRI HAMITI: Unë, në princip, i bashkohem diskutimit të kolegut Makolli. Nëse lexohen të dy variantet, e zakonisht nuk ka se si bëhet ndryshe, nëse amendamentohet një tekst, lexohen të dyja bashkë, absolutisht është më i qartë, më i shkurtër varianti ekzistues se ky. Unë e di, pak a shumë, është më tepër insistimi në një etikë se sa në precizim të nenit kjo që ka bërë Komisioni. Mua më duket që, megjithatë, ky formulimi i parë është më i saktë se sa ky i dyti, se sa amendamenti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti!
Zoti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!
Natyrisht që ne po e mbështesim propozimin që është në projektligj. Unë konsideroj që komisioni funksional ka dashur ta sqarojë, mirëpo vetë teknika si e ka hartuar, ka dalë më e paqartë, prandaj edhe unë mendoj që duhet të mbështetet propozimi si është në projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!
Zoti Riza Smaka e ka fjalën!

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti kryesues!
As formulimi në projektligj nuk është aq fatlumë, por megjithatë është më i qartë edhe do të isha angazhuar që të votojmë, natyrisht, jo ta imponojmë, por të votojmë për tekstin e projektligjit, natyrisht, kush do ta adoptonte edhe për amendamentin e dhënë në te. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka!
Zoti Armend Zemaj është paraqitur për fjalë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
Është e vërtetë se ndoshta pak dikush mund të ketë paqartësi, po nëse u dëgjua doktoresha me vëmendje, do të ishin hequr ato dilema. Qëllimi është për t'i integruar këta persona, për këtë është ndryshimi i këtij amendamenti.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj!
Zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Domethënë, unë po i bashkëngjitëm mendimit që e tha edhe ky është qëllimi. Qëllimi është vetëm etik, sepse mund t'i quajmë edhe sakatë, mund t'i quajmë edhe ndryshe- invalidë, por etike është që t'i quajmë persona me aftësi të kufizuar, ne të tjerët që kemi aftësi, që quhemi persona me aftësi, domethënë ta quajmë vetveten ndryshe. Për çështje etike ka ndodhur krejt ndryshimi.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina!
Zonja Nurishahe Hulaj e ka fjalën!

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!
Të nderuar deputetë,
Ky projektligj është i përpunuar në mënyrë shumë profesionale dhe qëllimi i amendamentit 5 është që çdo organizatë që merr të punësuar, çdo i 25-ti duhet të jetë i punësuar me aftësi të kufizuar. Pra, qëllimi i këtij amendamenti është punësimi dhe

krijimi i parakushteve të personave me aftësi të kufizuar për t' u punësuar, do të thotë për t'u integruar në shoqëri, që dallon prej paragrafit 2 të ligjit, është shumë i qartë edhe është shumë profesional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Nurishahe!
Zonja Suzan Novobrdaliu e ka fjalën!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Problemi nuk është në emërimin e këtyre personave, do të thotë, a janë me aftësi të kufizuara apo me nevoja të veçanta. Në këtë moment problemin e kemi në përmbajtjen e amendamentit numër 5, i cili me të vërtetë është i paqartë, në krahasim me përmbajtjen të cilën e ka pasur më herët. Edhe unë jam për të mbetur kjo përmbajtja e mëparshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kemi të paraqitur për të dytën herë, por në qoftë se më lejoni, unë do ta vë në votim amendamentin e komisionit.

Ju lutem, në qoftë se pajtohet Kuvendi, unë po e vë në votim amendamentin.

Regjia dhe deputetët, gati, votojmë amendamentin numër 5. Votojmë tash:

Ju njoftoj se me 22 vota janë “për”, 48 “kundër” dhe 6 abstenime, kështu që mbetet, praktikisht, neni 3.2 i Projektligjit, e jo amendamenti. Faleminderit!

Amendamenti 6.

Nuk ka të paraqitur për debat.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

I Komisionit funksional, regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Zoti Hydajet Hyseni është paraqitur për fjalë. Urdhëroni, zoti Hydajet. Tërhiqet. Zoti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po shfrytëzoj rastin të propozoj që ky projektligj gjithkund në vend të fjalës “persona me aftësi të kufizuara” të harmonizohet me konventat e reja për të drejtat e personave me nevoja të veçanta, dhe gjithkund shprehja “person me aftësi të kufizuar” të shndërrohet në “persona me nevoja të veçanta”. Kjo është edhe në përputhje me Konventën e re, të cilën Kosova do të duhej që ta ratifikojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli !

E ka fjalën Teuta Hadri.

TEUTA HADRI: Mendoj se për këtë ligj është diskutuar shumë, a të jenë persona me aftësi të kufizuar, apo si thotë edhe kolegu ynë, ka qenë në diskutim 2 – 3 vjeçar dhe si komision kemi rënë në dakord që është një koncept më i përshtatshëm i diskutimit, kështu që nëse e ndërrojmë, na duhet ta ndërrojmë përsëri krejt ligjin. Pra, lë të mbetet ashtu siç ka vendosur komisioni.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Teuta, po kërkoj falje që më parë nuk ua dhashë fjalën. Zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Jo, unë mendoj që duhet të mbetet ashtu si është propozuar nga komisioni funksional, sepse tash është vonë të propozojmë amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, edhe për faktin që jeni shumë të shkurtër në komente! Zoti Tali, a jeni tërhequr?

DRITON TALI: Po më duket se është diskutim i vonshëm, po megjithatë termi “me nevoja të veçanta” është më i përshtatshëm, por është futur gabimisht në këtë fjalorin tonë të korrektësisë politike. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Pra, janë paraqitur edhe Suzan dhe Njomëza. Fjalën e ka Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALU: Faleminderit, zoti kryesues! Mendoj se nuk është vonë që të zëvendësohet fjala ” persona me aftësi të kufizuar”, pra,” me nevoja të veçanta”, për arsye se ky ligj, më mirë të them projektligj, nuk ka hyrë ende në fuqi, nuk e kemi votuar ende. Do të thotë, nuk është vonë që të zëvendësohet kjo fjalë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Shikoni, ka mjaft të paraqitur, mirëpo për t’i ndryshuar variantet e amendamenteve, duhen propozime me shkrim, ju e dini këtë gjë. Unë po ju lus që mos të hymë në debate tash, sepse është vonë. Në qoftë se propozoni riformulimin e amendamenteve, ato do të duhej të bëhen me shkrim, ju e dini më mirë se unë. Prandaj, ju lutem, unë e kërkoj mirëkuptimin tuaj që të shkojmë në votim, sepse nuk mundemi ndryshe. Do të na bëhet një stërzgjatje e debateve, kështu që po e shpërdoroj, ndoshta, pozitën, mirëpo më lejoni ta hedh në votim amendamentin 8 të komisionit funksional.

Amendamenti 8

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota “për”, 5 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Për këtë amendament nuk ka të paraqitur, regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11, që është amendament personal i deputetes Teuta Hadri, pa mbështetjen e komisionit funksional.

E ka fjalën zonja Teuta Hadri.

TEUTA HADRI: Vetëm një sqarim. Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Shpresoj se amendamenti im do ta gjejë edhe mbështetjen e deputetëve, pasi këtu kemi të bëjmë me një kategori të veçantë të njerëzve që e kërkojnë jo vetëm një projektligj apo

ligj ta miratojmë këtu, po qëllimi është që ky ligj edhe ta gjejë mbështetjen - dorën e fortë të Qeverisë, janë persona të caktuar. Qëllimi im i këtij amendamenti ka qenë që të bëhet një zyre, një qendër koordinuese pranë Qeverisë. Pasi që e kemi vijën horizontale të veprimit, institucionet horizontale që i përshtaten kësaj kategorie, unë kam kërkuar që këtë kategori ta mbështesim edhe me një qeveri koordinuese, qendër koordinuese që duhet me të vërtetë t'i mbështesim, se dihet çfarë kategorie janë. Ka diskutime se ky amendament nuk ka gjetur mbështetjen e buxhetit të Kosovës. Besoj, nëse bëhet një analizë e veçantë dhe analizohet, këta persona të gjithë kanë nga një pagesë prej buxhetit të Kosovës, kështu që kjo zyre, qendër që formohet, nuk do ta ngarkojë buxhetin. Është edhe një deklaratë e Sallamonës, që shtetet më demokratike mbështesin këtë kategori, kështu që shpresoj se edhe Qeveria jonë ecën nëpër hapat e botës demokratike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hadri!
E ka fjalën zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit zoti kryesues!
Propozim amendamenti i deputetes Teuta Hadr, i edhe pse është qëllim mirë, zoti kryesues, megjithatë ky amendament mund të reflektojë në përzierje të kompetencave në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Pse e them këtë? Sepse, sipas propozimit kjo qendër i përgjigjet drejtpërdrejtë Qeverisë. Atëherë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale a janë qendra të cilat janë veç të formuara, a janë të Qeverisë apo të kujt janë? Mendoj, kjo nuk mund të zbatohet në praktikë, kështu ka vendosur edhe Komisioni funksional.

KRYESUESI: Zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari kryesues,
Këtu po shoh se kemi 44 amendamente dhe e dimë mirë të gjithë deputetët rrugën se si bëhet amendamentimi dhe çfarë bëhet në leximin e dytë dhe kush ka të drejtë ta marrë fjalën. Ka të drejtë ta marrë fjalën shefi i komisionit dhe, natyrisht, ai që ka bërë propozim personal të amendamentit të caktuar. Nëse shkojmë kështu, ne do të bëjmë 3 ditë gjersa t'i bëjmë 44 amendamente.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ramë Buja!
Unë, me kënaqësi do ta ndjek këshillën tuaj, në qoftë se nuk ka ndonjë protestë të fuqishme prej Parlamentit. Më lejoni, zonja e zotërinj, të bëj përjashtimin e fundit, t'ua jap fjalën Besa Gaxherit dhe Ardian Gjinit.

BESA GAXHERRI: Zoti kryesues,
E tha kolegu im, Buja, po edhe një herë ju lutem, në shqyrtimin e dytë të ligjeve nuk duhet ta marrin fjalën deputetët, aq më pak amendament për amendament. I kemi amendamentet përpara dhe, të lutem, mos na humbni kohë. Udhëhiqe seancën, secilin amendament e kemi përpara, kush do voton amendamentin e caktuar dhe të shkojmë tutje.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Besa! Zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Me krejt respektin, mendoj se dy kolegët e mi, parafolësit, e kanë gabim. Kur votojmë për amendamente, secili deputet ka të drejtë ta shfaqë mendimin edhe të tentojë ta bindë Kuvendin a të votojë apo mos të votojë për një amendament. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini!
Është paraqitur ministria Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari, zoti kryesues!
Unë mendoj se është vepruar drejt kur komisioni funksional nuk e ka përkrahur këtë amendament për faktin se, nëse themelohet një qendër koordinuese, kjo do të ketë implikime buxhetore.

Lidhur me këtë projektligj është siguruar nga Komisioni për Buxhet çështja e implikimeve buxhetore dhe tash nuk ka mundësi se si të kërkohet ose duhet të kthehet mbrapsht Ligji dhe të rillogariten implikimet buxhetore, ose të shkojë amendamenti i komisionit funksional.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë, deputete,
Më lejoni t'jua lexoj Rregulloren. Shqyrtimi i dytë i projektligjeve: “Përveç amendamenteve të propozuara nga komisioni përgjegjës- raportues dhe deputetët, Kuvendi shqyrton edhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve”, e tjera, e tjera .

“Propozuesit të amendamenteve i jepet e drejta që ta arsyetojë propozimin e vet me kërkesë të tij”. Ju lutem, që ta respektojmë, që tash e zbuluam. Unë për vete e zbulova se..., ta respektojmë këtë. Vetëm propozuesit do t'ia japim fjalën. Mua po me vjen keq, edhe zoti Koci po më duket aty e kishe fjalën për buxhetin, aty. Urdhëro, zoti Koci e ka fjalën!

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Desha edhe unë të jap një kontribut të veçantë lidhur me propozimin e këtij amendamenti. Një nga të drejtat e deputetit është edhe e drejta për të bërë amendamente, çfarëdo qofshin ato, në ligje e projektligje, prandaj zonja Teuta e ka shfrytëzuar të drejtën e vet të bëjë një amendament.

Komisioni për Buxhet, singerisht, në mënyrë serioze e ka shqyrtuar këtë amendament dhe në një mënyrë e ka përkrahur idenë e propozuesit, por nuk e ka pranuar për dy arsye kryesore. Njëra, për shkak të buxhetit që ka qenë shumë i limituar dhe, e dyta, po të futej ky si amendament, do të duhej komplet të ndërrohej struktura e ligjit, sepse ky amendament nuk përcakton se si do të funksiononte kjo zyrë, nën kompetencën e kujt do të ishte, sa punëtorë do të kishte, a do të ishte një agjencion i pavarur, ta quajmë në këtë farë mënyre, dhe do të duhej një kapitull i veçantë rreth kësaj qendre koordinuese.

Meqë, propozuesi nuk ka pasqyruar në amendamentin e vet se si do të funksiononte, thamë, në strukturën organizative, Komisioni për Buxhet nuk e ka përkrahur. Prandaj, u mbetet deputetëve të Kuvendit që të vendosin lidhur me këtë amendament të zonjës Teuta Hadri.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Koci!
Fjalën do t'ia japin zonjës Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit!

Zoti kryesues, unë ju lutem që t'i përmbaheni rregullit, sepse ky ligj nuk është diçka ndryshe nga ligjet e tjera dhe të votojmë amendament për amendament, ashtu sikur janë dhënë para jush.

Ju keni pasur kohë, të gjithë deputetët kanë pasur kohë që vërejtjet e tyre t'i thonë në shqyrtimin e parë dhe për tërë atë periudhë, prej shqyrtimit të parë deri tani, ne kemi qenë në dispozicion, si komision dhe si grup punues, që t'i shqyrtojmë amendamentet që kanë arritur. Nuk ka pasur amendamente tjera.

Kjo kategori pret që ne sot ta miratojmë ligjin dhe të mos tallemi dhe të jemi joserioz. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Flora!

Shkojmë, pra, në votimin të amendamentit 11, nga deputetja Teuta Hadri.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 30 vota "për", 36 "kundër", 7 abstenime, nuk miratohet amendamenti numër 11.

Amendamenti 12

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 74 vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 73 vota "për", asnjë "kundër", asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamentet janë të komisionit funksional, kur ka përjashtime, ia përmendi emrin amendamentuesit.

Amendamenti 14.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Me 71 vota "për", 1 "kundër", asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota "për", asnjë "kundër", 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. numër 15.

Amendamenti 16.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota "për", 1 "kundër", 1 abstenim.

Amendamenti 17.

Regjia gati, deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota "për", 2 "kundër" dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota "për", asnjë kundër, 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota "për", 1 "kundër" dhe asnjë abstenim miratohet amendamenti numër 19.

Amendamenti 20.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota "për", asnjë "kundër", 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 20

Amendamenti 21

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Me 69 vota "për", asnjë kundër, 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. 21.

Zot Makolli, jeni paraqitur për fjalë? Urdhëroni!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kam vërejtje po ashtu për amendamentin 22. Edhe ashtu gjendja e të punësuarave të kësaj kategorie, pra e njerëzve me nevoja të veçanta, në Kosovë është pothuajse zero dhe ky projektligj ka pasur për qëllim që të krijojë mekanizma edhe mundësi për punësimin e kësaj kategorie të njerëzve.

Po e shoh se komisioni funksional ka riformuluar ose ka amendamentuar këtë nen, duke sjellë prej 25 punëtorëve ose çdo i 25-ti punëtor, një nga ata të jetë i aftësisë të kufizuar, e ka kthyer në çdo 50 punëtorë.

Andaj, propozoj që për t'i dhënë mundësinë, për të krijuar mundësinë e barabartë, ashtu siç ne të gjithë e kemi gojën plot për mundësi të barabarta, që të mbetet neni që ka qenë në projektligj, që do të thotë se çdo i 25-ti punëtor i punësuar të jetë person me nevoja të veçanta. Kjo edhe njëherë do të dëshmonte se, në të vërtetë, ky Kuvend është i interesuar që të krijojë mekanizma të cilët do të ofronin mundësinë e punësimit për këtë kategori të njerëzve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Makolli. Fjalën e ka zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Atëherë, për këtë amendament, sigurisht, jemi mbledhur shumë herë dhe kemi debatuar edhe me shoqatat joqeveritare që mbështesin personat me aftësi të kufizuar, por edhe me bizneset. Bizneseve nuk mundemi t'u lëmë tërë barrën e gjendjes ekonomike shumë të rëndë. Kjo përqindje, do të thotë, është shumë e mirë, nëse duam të tregohemi human, por nuk mund ta bartin barrën kaq të rëndë, e kam fjalën për bizneset tona jo aq të forta. E dini se çka do të thotë, pra, për shembull, në një ndërmarrje në 1000 punëtorë, çdo i 25-ti të jetë me aftësi të kufizuar, është një...

Këtë e kemi kompensuar më vonë me amendamente të tjera dhe pasi është kthyer në mandatin e kaluar ky ligj, bash për shkak të këtij neni, një arsye që është kthyer, atëherë kemi bërë përmirësimin. Si qëndron kjo çështje në rajon? Në rajon është ngjashëm sikur është amendamenti 22.

KRYESUESI: Ju faleminderit, për shpjegime. Atëherë, votojmë amendamentin 22 të komisionit funksional.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 49 vota “për”, 21 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 22

Amendamenti 23

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” 1 abstenim, miratohet amendamenti 23

Amendamenti 24

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë kundër, 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. numër 24.

Amendamenti 25

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Regjia gati, deputetët gati votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” 1 abstenim, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Regjia gati, deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për” asnjë “kundër”, asnjë abstenim , miratohet amendamenti nr. 28.

Amendamenti 29

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 30.

Amendamenti 31

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. 33.

Zoti, Driton Tali është paraqitur për fjalë.

DRITON TALI: Pak vonë, po e di që nuk kam grup parlamentar, nga një herë po anashkalohem. Megjithatë, ngase ma dhatë fjalën, veç desha të tregoj sa absurde jemi duke e përdorur fjalën “me aftësi të kufizuara”. Te 31-shi, vetëm lexoni: “Për personat me aftësi të kufizuara 100%”. Unë s’ di kush është ai person me aftësi të kufizuara 100%, ai është person i paaftë. Unë që në fillim pata kërkuar që në ligj ta kemi fjalën si krejt bota “për personat e paaftë” dhe në vokabularin politik t’i përdorim “personat me aftësi të sfiduara apo me nevoja të veçanta”. Veç këtë desha ta them dhe është shembull shumë i mirë amendamenti 31, lexojeni se sa i pakuptimtë është! Ju faleminderit!

Amendamenti 34

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Regjia gati, deputetët gati. votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti nr. 38.

Amendamenti 39

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr. 39.

Amendamenti 40

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti nr. 40.

Amendamenti 41

Regjia gati, deputetët gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 41.

Kalojmë në amendamentin 42.

Regjia, gati, deputetët, gati! Votojmë tash:

Amendamenti 42 miratohet me 70 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim.

Kalojmë tek amendamenti numër 43.

Regjia, gati, deputetët gati! Votojmë tash:

Amendamenti 43 ka marrë 71 votë “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet.

Kalojmë te amendamenti i fundit 44.

Regjia, gati, deputetët gati! Votojmë tash:

Amendamenti i fundit ka marrë 72 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet.

Dhe tani, zonja e zotërinj deputete e deputetë, do të votojmë tekstin e Ligjit në tërësi, bashkë me amendamentet e miratuara.

Regjia, gati, deputetët, gati. Votojmë tash:

Konstatoj se me 75 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet Projektligji i parashtruar dhe shndërrohet në ligj.

Ju njoftoj, gjithashtu, se në sallë janë të pranishëm 78 deputetë.

Ju faleminderit! Pra, më lejoni të konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Tash “vox populi” kërkon drekë për një orë e gjysmë dhe a e lëmë në dispozicion? Një orë, a e lëmë në dispozicion, pyes shefat e grupeve?

Në rregull, po vazhdojmë.

Në radhë është pika tjetër e radhës së rendit të ditës dhe pikërisht:

- Projektligji për Presidentin e Republikës

Këtë e kemi hequr nga rendi i ditës.

Dhe, pika tjetër sipas radhës, është:

- Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe Kuvendit ia kanë parashtruar rekomandimet e tyre. Ftoj zotin Gani Koci, që është kryetar i komisionit funksional, që para deputetëve ta prezantojë raportin me rekomandime. Zoti Koci, e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Komisioni me konsensus të plotë ka bërë amendamentimin jo vetëm të këtij ligji, por edhe të tri ligjeve të tjera që do t'i shqyrtojmë tash dhe do t'i miratojmë amendamentet, prandaj thërras deputetët që t'i votojmë në mënyrë pak më të përshpejtuar për shkak se Komisioni për Buxhet, menjëherë pas kësaj seance ka një takim që duhet t'i përgatisë amendamentet për Projektbuxhetin për vitin 2009.

KRYTARI I KUVENDIT: Faleminderit!

Të lajmëruar për diskutim nuk kemi. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Regjia le të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 11 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit zoti Kryetar!

Edhe njëherë po e përsërisim atë që e kemi thënë më herët, që ky ligj është totalisht i gabueshëm dhe jo vetëm që nuk do ta votojmë, por e thërrasim Kuvendin që të votojë kundër amendamenteve dhe të ligjit në tërësi, për shkak se shkakton probleme serioze morale në të gjithë atë që kemi bërë deri më tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me votim. Votojmë amendamentin numër 2.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Regjia, përgatitemi për votim!

Konstatohet se me 47 vota “për”, 20 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Regjia, le të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 21 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Në radhë është amendamenti numër 4.

Regjia, përgatitemi për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 19 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin numër 4.

Në radhë është amendamenti 5.

Regjia, përgatitemi për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 20 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti numër 5.

Amendamenti numër 6.

Urdhëroni, Hydajet, pasi e keni kërkuar fjalën. Më herët e paske kërkuar fjalën, por që tash po e shoh në ekran.

HYDAJET HYSENI: Zoti Kryetar, Ju faleminderit! E kisha fjalën për këtë dispozitën përfundimtare që e kemi edhe në disa ligje. Në ligjin e mëparshëm ne e ndryshuam dhe mendoj, e ndryshuam mirë, që të jetë vetëm “Ligji hyn në fuqi pas shpalljes në “Gazetën zyrtare” ose, nëse ka termin të caktuar, për arsye të veçanta. Por, kjo pjesa që është në

këtë ligj dhe në disa ligje që do të vijnë, në të cilat thuhet “pas miratimit nga Kuvendi” nuk ka kuptim, sepse ligji edhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga Kuvendi, por edhe nuk ka kuptim, sepse kjo mbetet në ligj pasi ne veç e kemi miratuar nga Kuvendi. Prandaj, mendoj se kjo gjithkund duhet të hiqet që të standardizohet siç duhet metodologjia ligjvënëse. Faleminderit!

KRYETARI: Jemi dakord, do të thotë, të kihet parasysh që të gjitha këto nene të standardizohen dhe të kenë një format.

Tash përgatitemi për votim në tërësi të ligjit. Lus regjinë të përgatitet për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota “për”, 23 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin mbi tatimin e vlerës së shtuar. Faleminderit!

Në rend dite kemi pikën:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për tatimin e të ardhurave të korporatave dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Pasi që askush nuk e ka kërkuar fjalën, kalojmë në votim. Regjia të përgatitet për votim të amendamentit numër 1. Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 7 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 1.

Votojmë amendamentin numër 2.

Regjia, të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 6 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin numër 2.

Në radhë është amendamenti numër 3.

Regjia, të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 5 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Në radhë është amendamenti 4.

Regjia, të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 5 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Në radhë është amendamenti 5.

Regjia, të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 7 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Dhe, amendamenti i fundit 6.

Edhe amendamenti 6 standardizohet si për ligjin paraprak.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, 5 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Tani përgatitemi për të votuar tekstin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Regjia, të përgatiteni për votim! Votojmë tash:

Në sallë janë 78 deputetë. Konstatoj se me 57 vota “për”, 6 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave. Ju faleminderit!

Në radhë kemi:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimet në të ardhurat individuale

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat individuale dhe Kuvendit ia kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Për fjalë është lajmëruar Ardian Gjini. Urdhëroni!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar! Edhe njëherë po flas për gjithë këtë çështje dhe për sot do të jetë apeli i fundit. Kjo formë e uljes së taksave në të ardhurat personale prapë është në disavantazh të njerëzve të cilët kanë të ardhura të ulëta dhe të cilët janë të varfër. Në këtë rast, prapë privilegjoohen ata që kanë të ardhura të mëdha dhe dënohen ata që kanë të ardhura të ulëta. Kjo është në linjë me atë që bëmë më përpara dhe që po përmenden centët. Kjo është prapë në linjë me të gjitha ligjet që po i votojmë sot, të cilat janë ligje që do ta varfërojnë popullin e Kosovës edhe më tej. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci.

GANI KOCI: Unë dua të përsëris vetëm atë që thashë në fillim. Në Komisionin për Buxhet e Financa të gjithë anëtarët kanë pasur një konsensus për këto projektligje, që i kemi në shqyrtim, edhe për amendamentet e propozuara. Ka pasur konsensus për arsye se Qeveria ka premtuar dhe këtë premtim duhet ta mbajë, sepse në tremujorin e parë të vitit 2009 duhet të sjellë katër ligje komplete të cilat ne sot po i miratojmë këtu. Prandaj, çdo diskutim, në emër të këtij apo atij grupacioni, në këtë rast, për mua është i papranueshëm dhe t’i kryejmë, t’i votojmë dhe të shkojmë përpara.

KRYETARI: Faleminderit! Kalojmë në votim të amendamentit numër 1.

Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatoj se me 49 vota “për”, 16 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi amendamentin numër 1.

Në radhë është amendamenti numër 2.

Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatoj se me 45 vota “për”, 15 “kundër”, 8 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 2.

Edhe për amendamentin 3 vlen e njëjta gjë, si për dy amendamentet përfundimtare në ligjet paraprake.

Amendamenti 3.

Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 17 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Tani votojmë tekstin në tërësi, me amendamentet e votuara. Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 18 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për tatimet në të ardhurat individuale.

Në radhë është:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për normën e akcizës në Kosovë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për normën e akcizës në Kosovë dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Nuk e ka kërkuar fjalën as kryetari i Komisionit, andaj vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Votojmë amendamentin numër 1.

Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatohet se me 49 vota “për”, 10 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti numër 1.

Në radhë është amendamenti numër 2.

Regjia, votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 10 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin numër 2.

Në radhë është amendamenti 3.

Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 11 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Në radhë është amendamenti i fundit 4.

Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 11 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Një sqarim. Për amendamentin numër 2 vlen sikur për amendamentet e ligjeve paraprahe. Do të thotë, ndryshimi bëhet sipas standardizimit.

Në radhë është votimi i Ligjit në tërësi, me amendamentet e votuara. Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim! Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 13 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Projektligjin për normën e akcizës në Kosovë.

Në radhë është:

- Shqyrtimi i Ligjit për taksën e akomodimit në objektet hoteliere dhe turistike

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, Komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për taksën e akomodimit të objekteve hoteliere dhe turistike dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Të paraqitur për fjalë nuk ka. Kalojmë në votim.

Votojmë amendamentin numër 1.

Regjia, të përgatitet për votim! Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, 3 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Në radhë është amendamenti 2, gjithnjë i komisionit funksional dhe Komisionit për Buxhet.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti numër 2.

Në radhë është amendamenti 3 i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 “abstenim”, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Në radhë është amendamenti nr. 4 i Komisionit për Buxhet e Financa, i përkrahur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 4.

Amendamenti i fundit është amendamenti 5 i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Radha është për ta votuar Ligjin në tërësi, me amendamentet e votuara.

Regjia, të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për taksën e akomodimit në objektet hoteliere dhe turistike.

Të nderuar deputetë,

Me kaq seancën e deklarohet të mbyllur. Mirë u pafshim në seancën e radhës, e cila do të mbahet më 19 dhjetor 2008, në orën 10:00.

Përgatiti:
Njësia e Transkripteve